



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 512/2 Prot.

Tiranë, më 30.05.2023

V E N D I M

Nr. 79, Datë 30.05.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 64, datë 19.04.2023, e paraqitur nga Qendra T’REJA kundër Platformës e-albania, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “moshës” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë të trajtohet problemi i mungesës së aksesit të grupeve në nevojë, në portalin e-albania. Në Bashkinë e Korçës, grupe të ndryshme të tilla si: moshë e tretë, persona të pakicës romë dhe pakicës egjiptiane, persona me aftësi të kufizuara, hasin shumë vështirësi në gjenerimin e dokumentacioneve të nevojshme nga kjo platformë. Vështirësitë lidhen me faktorë të tillë si: - Mungesa e një numri telefoni për çdo anëtar të familjes; - Mungesa e arsimit dhe njohurive bazë kompjuterike; - Mungesa e internetit dhe pajisjeve elektronike. Duke mos gjeneruar në kohë dokumentacionin, personat përjashtohen nga përfitimi i shërbimeve publike të tilla si aplikimi për ndihmën ekonomike, subvencionimin e qirasë, etj. Kjo situatë ka krijuar vend për abuzime nga bizneset private të cilat tashmë kërkojnë shuma monetare të papërbalueshme për grupet në nevojë, ndërkohë që ky shërbim pretendohet të jetë falas me raste përjashtuese”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndërhyrjen e Komisionerit me anë të një rekomandimi për ofrimin e alternativave për grupet në nevojë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga subjekti ankues informacion dhe dokumentacion plotësues.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 20.04.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të paraqesë informacionin dhe dokumentacionin si më poshtë:
 - Lidhur me subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminim, duhet të identifikoni subjektin kundër të cilit ankoheni, pasi e-albania është platformë aplikimi online.
 - Lidhur me procedurën e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike apo programet e tjera të mbrojtjes sociale, nga ana e pensionistëve, anëtarëve të pakicës kombëtare Rome dhe pakicës kombëtare Egjiptiane dhe personave me aftësi të kufizuara, kërkojmë nga ana Juaj një informacion të hollësishëm mbi raste konkrete të personave që nuk kanë mundur të kryejnë aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, etj. Si dhe çdo informacion tjetër që do e gjykoni të arsyeshëm dhe do ndihmonte në sqarimin e kësaj çështjeje.
 - Lidhur me sa më sipër, kërkojmë që brenda mundësive, të shkruani të dhënat e këtyre personave (por jo vetëm të atyre), datën kur kanë aplikuar, Njësinë Administrative apo institucionin ku ato nuk kanë marrë shërbimin.
 - Informacion për përgjigjen që kanë marrë nga administratori shoqëror apo ndonjë person tjetër i autorizuar, lidhur me mosofrimin e ndihmës për të plotësuar aplikimin (në sportel apo në telefon), datën dhe Njësinë Administrative/institucionin, ku ka ndodhur ngjarja.
 - Lidhur me personat që nuk kanë marrë shërbimin duhet që të bashkëlidhen fakte dhe prova për të vërtetuar shkakun (pensioniste, pakicë rome, pakicë egjiptiane, PAK) dhe aktin e përfaqësimit të tyre nga ju.

Subjekti ankues, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk dërgoi asnjë dokumentacion lidhur me ankesën dhe nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga Qendra T'REJA, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA